

STATUT I SHOQERISE
“EAL Corp” Sh.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 26.02.2020 personat e mëposhtem:

Z.ADMIR SHIMA, atesia Agim, shtetase shqiptare, e datelindjes 21.11.1990, lindur dhe banuese ne Durres, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, posedeus i pasporte, me Nr.BJ7849516 dhe Nr.Personal J011210070.

ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, te ndryshuar, dhe me legjislacionin e zbatueshem ne Republiken e Shqiperise, ka miratuar kete Statut si vijon:

KAPITULLI I
THEMELIMI – EMRI – FORMA – SELIA - OBJEKTI – KOHEZGJATJA

Neni 1

Themelimi, Emri dhe Forma

Emri dhe emertimi tregtar i Shoqerise eshte “EAL Corp” Sh.P.K.

Shoqeria “EAL Corp” Sh.P.K. eshte nje person juridik privat, e themeluar ne baze te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008, “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” (me pas referuar si “Ligji Tregtar”) ne formen e Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar (Sh.P.K.).

Shoqeria fiton personalitetin juridik me regjistrimin e saj ne regjistrin tregtar qe mbahet nga Qendra Kombetare e Regjistrimit (me pas referuar si “QKR”) ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga ligji.

Me fitimin e personalitetit juridik, Shoqeria behet pergjegjese kundrejt paleve te treta, per detyrimet dhe demet qe shkakton gjate veprimtarise se saj.

Ortaket e Shoqerise do te jene pergjegjes kundrejt paleve te treta deri ne shumen e kontributit te derdhur ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

Neni 2

Selia

Shoqeria do ta kete seline e saj ne adresen e mëposhtme: Rr. “Reshit Çollaku” Kulla NR. 1, Kati 9, Ap. 43, Tirane, Shqiperi.

Me vendim te Administratorit, Shoqeria mund te çele dege dhe/ose zyra perfaqesimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë sa vijon:

- Marketing, reklamim, data entry, online services, Sherbime informacioni teknologjie.



Sidoqoftë, asgjë nuk do të interpretohet këtu si kufizim i mundësisë së shoqërisë për të hyrë në tregje apo aktivitete dhe operacione të tjera tregtare që janë të lidhura me apo në funksion të objektit të mësipërm.

Objekti i aktivitetit të Shoqërisë mund të ndryshohet dhe/ose zgjerohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe këtë Statut.

Neni 4

Kohezgjatja

Kohezgjatja e Shoqërisë është e pakufizuar. Shoqëria mund të priset në çdo kohë me një vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortave, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

KAPITULLI II

KAPITALI – KUOTAT

Neni 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,000 Lekë (një mijë Lekë). Kapitali themeltar përbehet nga 1 (një) kuote që janë paguar e zotërohen teresisht nga ortakët themelues si vijon:

- Ortaku **Z. ADMIR SHIMA**, zotëron 1 (një) kuote me vlerë nominale 100,000 leke (njëqind mijë), që përfaqëson 100% të kuotave të kapitalit themeltar të Shoqërisë.

Ortakët janë përgjegjës kundrejt paleve të treta për humbjet që pëson Shoqëria, deri në shumën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblese së Përgjithshme të Ortave, në përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6

Kuotat

Te drejtat dhe detyrimet e lidhura

Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotes së tij.

Pronesia mbi kuotat do të regjistrohet në regjistrin e ortakëve që do të mbahet në seline të Shoqërisë nën përgjegjësinë e Administratoreve (“**Regjistri i Ortave**”).

Regjistri i Ortave do të pasqyrojë informacionin e mëposhtem: (i) identitetin e çdo Ortaku; (ii) numrin dhe vlerën e kuotes që zotërohet nga çdo Ortak; (iii) datën e fitimit të pronësive të secilit Ortak mbi kuotat; (iv) adresën apo seline të çdo Ortaku; (v) detaje për çdo peng apo barre të vendosur mbi kuotat.

Neni 7

Transferimi i Kuotave

7.1. Nëse një Ortak ka për qëllim të transferojë në çdo formë të gjithë apo një pjesë të kuotes së tij një personi të ndryshëm nga ortakët, secili prej Ortave të tjera ka të drejtën e parablerjes mbi të gjithë apo një pjesë të kuotes në përjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin themeltar, në varesi të faktit se sa ortakë do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes në rastin konkret. E drejta e parablerjes ushtrohet vetëm në përputhje me procedurën në vijim.



- 7.2. Nese nje Ortak ka per qellim te transferoje te gjithë apo nje pjese te kuotes se tij, ai, perpara se te nenshkruaje marreveshje me persona te ndryshem nga Ortaket, do te njoftoje me shkrim Administratoret per transferimin e planifikuar, duke percaktuar edhe çmimin e transferimit, personin/at te cileve planifikon t'u transferoje kuoten dhe kushtet esenciale qe do te aplikohen per transferimin.
- 7.3. Administratoret, brenda 10 diteve duke filluar nga dita kur eshte njoftuar nga Ortaku per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te informojne me shkrim Ortaket e tjere.
- 7.4. Secili prej Ortakeve qe ka te drejta parablerjeje, brenda 1 (nje) muaji nga njoftimi prej Administratoreve per shitjen apo transferimin e planifikuar, do te njoftoje me shkrim Administratoret nese ka qellim te ushtroje te drejten e tij te parablerjes.
- 7.5. Administratoret brenda 10 diteve nga marrja e ketij njoftimi do te njoftojne me shkrim Ortakun qe deshiron te transferoje kuotat e tij.
- 7.6. Nese me shume se nje Ortake ushtrojne te drejtat e parablerjes se kuotes, ata do te blejne kuoten ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar.
- 7.7. Nese asnje njoftim nuk eshte dhene nga ndonje Ortak si me sipër, Ortaku qe ka per qellim te transferoje kuoten e tij do te jete i lire t'ia transferoje kete kuote personit/ave te percaktuar prej tij.
- 7.8. Nese vetem nje Ortak ka dhene njoftim per qellimin e tij per te ushtruar te drejten e parablerjes, ky Ortak do te kete te drejte te bleje kuoten objekt transferimi brenda 10 diteve nga data e mbarimit te afatit 1 (nje) mujor te percaktuar me sipër.
- 7.9. Çdo transferim i kuotave qe nuk kryhet ne perputhje me parashikimet e ketij neni eshte i pavlefshem dhe pa efekte per Shoqerine.

Neni 8

Zmadhimi i Kapitalit

Kapitali themeltar mund te zmadhohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, nepermjet emetimit te kuotave te reja ose rritjes se vleres nominale te atyre ekzistuese ose ne çdo forme tjeter te parashikuar nga Ligji. Per cdo zmadhim kapitali te Shoqerise nepermjet emetimit te kuotave te reja, Ortaket do te kene te drejten e parablerjes per nenshkrimin e ketyre kuotave te reja te emetuara. Nese me shume se 1 (nje) Ortak ushtrojne te drejtat e tyre te parablerjes brenda 20 (njetzet) diteve, atehere ata do t'i blejne keto kuota ne perpjestim me pjesemarrjen e tyre aktuale ne kapitalin themeltar. Çdo kuote e re qe nuk eshte blere nga Ortaket gjate ketij procesi, i ofrohet çdo pale te trete.

Kuotat e reja qe do te shlyhen si me para ne dore, ashtu edhe ne natyre, do te paguhen ne perputhje me Vendimin perkates per zmadhimin e kapitalit dhe Ligjin per Shoqerite Tregtare.

Neni 9

Zvogelimi i Kapitalit

Kapitali mund te zvogelohet, me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne perputhje me Ligjin per Shoqerite Tregtare.

KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE

Neni 10

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve



Asambleja e Pergjithshme do te jete organi me i larte i Shoqerise, i cili, veç kompetencave te tjera sipas Ligjit per Shoqerite Tregtare apo ketij Statuti, merr vendime per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- a. percaktimi i politikave tregtare;
- b. ndryshime te Statutit;
- c. emerimi i Administratoreve;
- d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
- e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
- f. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve te ecurise se veprimtarise se Shoqerise;
- g. shperndarjen e fitimeve vjetore;
- i. zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit themeltar te Shoqerise;
- j. pjesetimin dhe anulimin e kuotave;
- k. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime;
- l. riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- m. miratimin e rregullave te zbatueshme procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera sipas parashikimeve te bera prej ketij Statuti.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mblidhet ne rastet e percaktuara nga ligjet e aplikueshme ose nga ky Statut dhe sa here qe eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme mblidhet te pakten nje here ne vit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese se Pergjithshme mund te dergohet me shkrim apo e-mail ne adresat qe secili Ortak do t'i njoftoje me shkrim Shoqerise me poste te regjistruar. Njoftimi do te konsiderohet se i eshte dorezuar Shoqerise me kalimin e dites se 10-te pas dergimit.

Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te percaktojte qarte emrin e Shoqerise, seline, daten, kohen dhe vendin e mbledhjes, nje pershkrim te hollesishem te procedures qe duhet te ndiqet nga Ortaket per pjesemarrjen dhe votimin, informacion mbi vendin e menyren e marrjes se dokumenteve dhe projekt-vendimeve qe duhet tu vihen ne dispozicion te gjithe Ortakeve, po ashtu edhe rendin e dites, dhe duhet t'u njoftohet Ortakeve te pakten 14 (katërmbëdhjetë) dite para mbledhjes. Rendi i dites i njoftuar si me siper duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje. Nese Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve duhet te vendose per ndryshime te Statutit, teksti perkates duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites. Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve do te thirret nga Administratoret dhe, kur eshte e zbatueshme, nga Ortaket.

Nje Ortak mund te perfaqesohet ne Asamblene e Pergjithshme te Ortakeve nga nje ortak tjetër apo nga nje person i trete i ndryshem nga Administratoret, duke paraqitur dokumentin perkates autorizues. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te nejtin rend dite.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.



Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zoteruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga Ligji Tregtar, vlefshmeria e vendimeve që përcaktojnë detyrime shtese ose kufizojnë / zvogelojnë të drejtat që u janë njohur ortakëve nga Ligji Tregtar apo nga ky Statut, kushtezohet nga miratimi i Ortakut të interesuar / perkates.

Të gjitha vendimet e Asamblese duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët janë përgjegjës për mbajtjen e një kopjeje të tij.

Neni 11

Organi Administrues / Administratorët

Organi Administrues përbehet nga 1 (një) Administrator që emërohet e shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve. Kohegjatja e mandatit të Administratorit është 5 (pese) vjet, me të drejtë ri-emërimi.

Personi i mëposhtëm caktohen si Administrator i vetëm i shoqërisë me mandat 5 vjeçar:

- **Z. Admir Shima**, atesia Agim, shtetase shqiptare, e datelindjes 21.11.1990, lindur dhe banuese në Durrës, madhor dhe me zotësi të plote juridike për të vepruar, posedues i pasporte, me Nr.BJ7849516 dhe Nr.Personal J011210070.

Administratori përfaqëson Shoqërinë sipas parashikimeve të Statutit.

Administratori do të:

- administrojë veprimtarinë tregtare të Shoqërisë duke zbatuar politikën tregtare të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
- përfaqësojë Shoqërinë;
- kujdeset për mbajtjen e rregullt të librave dhe dokumenteve kontabel;
- përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilat ia paraqet Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve;
- krijojë një sistem njoftimi të përshtatshëm për rrethanat që kërcenojnë ekzistencën e Shoqërisë;
- kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhenave të Shoqërisë, sipas kërkesave të Ligjit Tregtar apo të ligjeve të tjera të zbatueshme;
- raportoje përpara Asamblese së Përgjithshme të Ortakëve mbi zbatimin e politikave tregtare si dhe për perfundimin e transaksioneve me rëndësi të veçante për performancën e Shoqërisë;



- (viii) kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne kete Statut;
- (ix) therrase mbledhjen e Asamblese se Ortakeve sa here qe kerkohet sipas Ligjit apo ketij Statuti. Administratori mund te autorizoje persona te tjere per te vepruar ne emri dhe per llogarine e tij, duke specifikuar / percaktuar kategorine e akteve dhe veprimeve qe perfaqesuesi mund te kryeje. Veç kufizimeve ligjore, nuk vendosen kufizime te kompetencave te administrimit.

Neni 12
Kontrolli i Shoqerise

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve mund te emeruje nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar per kontrollin e llogarive te Shoqerise.

KAPITULLI IV
VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, FITIMET DHE REZERVAT LIGJORE

Neni 13
Viti Financiar

Viti financiar ka nje kohezgjatje prej 12 (dymbedhete) muajsh e cila fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Ne menyre perjashtimore, viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar.

Neni 14
Rezerva Ligjore

Shoqeria do te kaloje ne fondin rezerve te detyrueshem te pakten 5% (pese perqind) te fitimit vjetor neto derisa kjo rezerve te arrije vleren e barabarte me 10 per qind te kapitalit themeltar.

Neni 15
Dividendet

Pas miratimi te bilancit vletor dhe percaktimit te shumes qe do te ndahet, Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve percakton shumen e fitimeve qe do t'i shperndahet secilit prej Ortakeve si dividend, ne perpjestim me pjesen perkatese ne kapitalin themeltar.

KAPITULLI V
PRISHJA - LIKUIDIMI

Neni 16
Prishja e Shoqerise

Shoqeria priset (i) me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve; ose (ii) ne rast falimentimi; ose (iii) kur Shoqeria nuk ka kryer veprimtari per 2 (dy) vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne QKR; ose (iv) me vendim gjykate; ose (v) per arsye te tjera te parashikuara ne ligj.

Neni 17
Likuidimi

Me perjashtim te rastit te fillimit te nje procedure falimentimi, prishja e Shoqerise shoqerohet me fillimin e procedures se likuidimit.



Neni 18
Dispozita Perfundimtare

Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit Tregtar. Konfliktet ne lidhje me kete Statut do te zgjidhen nga gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e se ciles Shoqeria ka seline e saj.

Me qellim shmangien e cdo paqartesisie, ndryshimi i ortakeve dhe/ose Administratorit, dhe/ose cdo funksionari tjetere nuk do te konsiderohen si ndryshime te ketij Statuti.

Për ndjekjen e të gjithë procedurave në lidhje me regjistrimin fillestar të Shoqërisë dhe akteve përkatëse në Regjistrin Tregtar (QKR) ne autorizojme nepermjet ketij akti Z. Admir Shima i cili mund të paraqiten e veprojnë veçmas apo së bashku me të drejta e kompetenca të plota për nënshkrimin dhe dorëzimin e çdo aplikimi, kërkesë dhe/ose dokumenti që konsiderohet se duhet paraqitur pranë Regjistrin Tregtar për kompletimin e regjistrimit.

Ky Statut nenshkruhet rregullisht ne 3 (tre) origjinale ne gjuhet Shqipe

ORTAKET THEMELUES

ADMIR SHIMA

Admir Shima 